# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449386**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Veliaj mbetet në paraburgim/ Manjani: Ka përplasje mes gjykatave. Rumano: Nuk përmbush kushtet për burg |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/16/veliaj-mbetet-ne-paraburgim-manjani-ka-perplasje-mes-gjykatave-rumano-nuk-permbush-kushtet-per-burg/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 13:44:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 13:41:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 13:40:00 UTC → 16 shtator 2026, 13:42:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `48d3052016ea5acaf74f007c7f0645f8042901c7915bf30b318eb638e3c493e5` |
| TEKSTI | `8b51267fc96a2306536c5eee9988a3da6f995580552f298f708055912717a76e` |
| PAMJA | `c6916e1dca21cb8b23cd132dbd80f48afbaecaa2c047f77c9e9da07c3a014a7b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `37065adfb44ddc7042b7acc2bcf59d9cf5e0c4748731c81e522dd236b3a2e3ac` |
| E MËPARSHMJA | `04c7716473e5e582bcc1681586f2cf91078e2d71ba745240b8f8beffcbf9048c` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/37065adfb44ddc7042b7acc2bcf59d9cf5e0c4748731c81e522dd236b3a2e3ac`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

# Veliaj mbetet në paraburgim/ Manjani: Ka përplasje mes gjykatave. Rumano: Nuk përmbush kushtet për burg

16/09/2026 15:41



**Pas 19 muajsh në qeli, kryebashkiaku i Tiranës humbi edhe betejën e fundit për një masë më të butë sigurie. Avokatët ngrenë pikëpyetje mbi proporcionalitetin dhe përputhjen me jurisprudencën e Kushtetueses.**

Arsyetimi i plotë pritet brenda 60 ditëve, ndërsa procesi për themelin vijon pa një vendim për fajësinë.

Gjykata e Lartë në unanimitet la në fuqi masën arrest me burg ndaj Erion Veliajt, Kryetar bashkie në detyrë, kjo dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese e cila në dy vendime të tjera i ka kërkuar Gjykatës së Posaçme më shumë argumentim në lidhje me proporcionalitetin e masës së dhënë. Sipas vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të vetë Gjykatës së Lartë, dhënë në maj të këtij viti, për masat e sigurisë duhen vlerësuar konkretisht rrezikshmëria e veprës dhe e personit, mënyra e kryerjes, pasojat, personaliteti, sjellja dhe rrethanat individuale e familjare. Për rastin Veliaj duhet parë se cilat janë rreziqet konkrete që gjykata ka konstatuar dhe, mbi të gjitha, pse masat alternative nuk janë konsideruar të mjaftueshme pas 19 muajsh paraburgim?

Juristi Gentjan Rumano tha se "Duhet të vlerësohet në raport me rrezikshmërinë e subjektit që kërkohet masa e sigurimit. Parë në këtë këndvështrim zoti Veliaj nuk përmbush kushtet të qëndrojë në burg. Nuk ka rrezikshmëri shoqërore. Është kryetar bashkie i zgjedhur më shumë se sa gjysma e banorëve të Tiranës. Nëse rrezikon sistemin, le të aplikohet pezullimi. Duhet parë mundësia pse nuk është e përshtatshme një masë më e butë."

Vendimi i zbardhur ende nuk është publikuar dhe pritet të zbardhet brenda 60 ditëve, për të kuptuar se pse gjykata ka marrë këtë vendim që në syrin e juristëve krijon një përplasje.

Juristi Ylli Manjani thotë se ka një përplasje mes Vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë "Dukshëm kemi një përplasje ndërmjet vendimeve të Gjykatës Kushtetuese vendimet e vetë Gjykatës së Lartë për të unifikuar dhe njehsuar praktikën në raport me masat e sigurisë dhe me rastin Veliaj. Pyetjet që lindin janë të shumta. Së pari, A e njeh autoritetin e Gjykatës Kushtetuese Gjykata e Lartë, së dyti, Gjykata e Lartë a e njeh autoritetin e vetes së vet. Së treti, çfarë mesazhi jep Gjykata e Lartë kur nuk zbaton vendimet e veta dhe të Gjykatës Kushtetuese."

Ndërkohë Veliaj humbi betejën e radhës për masën e sigurisë. Ai qëndron në paraburgimin e Durrësit që nga 10 shkurti i vitit të kaluar teksa çështja është në fazën e gjykimit dhe gjykata ende nuk është shprehur për fajësinë e tij.

**Top Channel**


## Kryesore



Live/ Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së, Thaçi, Krasniqi, Veseli e Selimi. Të pafajshëm për krime kundër njerëzimit
14:50

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!
11:43

Vendimi i gjykatës së Hagës, qytetarët shprehin revoltë në Prishtinë: Nuk ia vlen të jetosh kur vendi yt shkatërrohet! Dëgjohen krisma armësh
11:58

Foto/ Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së
13:21

"UÇK nuk është vetëm një emër në histori"/ Sulmuesi i Kombëtares shqiptare reagon pas vendimit të marrë në Hagë
13:49

## Më të lexuarat

Live/ Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së, Thaçi, Krasniqi, Veseli e Selimi. Të pafajshëm për krime kundër njerëzimit

Gjykata speciale në Hagë dënon me 81 vite në total për ish-liderët e UÇK, protestë masive në Prishtinë

"A ka rrezik të vdesë në burg?"/ Milaim Zeka shpërthen në lot, tregon komentin e vajzës për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së

Seanca për ish-krerët e UÇK-së në Hagë, gjykata dënon me 25 vite burg Hashim Thaçin

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!

"Po e vendosin njerëzimin në rrugën e shkatërrimit", Rusia sulmon SHBA-në pasi pranoi se ka sisteme armësh në hapësirë

"Puna e SPAK, efektive", mesazhe të forta nga zyrtari i DASH, Lawton: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale

Japonia thyen rekorde, kalon për herë të parë shifrën e 100 mijë persona mbi moshën 100-vjeçare, pjesa më e madhe janë gra

"U vërtetua arrestimi i paligjshëm i së paku

385 personave"/ Trupi gjykues: Të ndaluarit u rrahën dhe iu shkaktuan vuajtje psikologjike

Rama udhëton drejt SHBA-së në 20 shtator, zbardhen detaje nga takimet që pritet të zhvillojë

## Aktualitet »



Hetimet për Ballukun/ Pas emaileve për vilën në Palasë, arkitektët merren në pyetje nga SPAK

16/09 15:44



Gjykata e Lartë kundër projektligjit për pagat e magjistratëve: Kuvendi të mos e votojë

16/09 15:19



Seanca në Apelin e Posaçëm, Ilir Meta: Nuk kam munguar asnjëherë në gjyq

16/09 14:37



Kishte përshtatur lokalin për organizimin e lojërave të fatit dhe shitje droge, arrestohet pronari, procedohet i biri

16/09 14:18



Konflikti për pagat/ Disa gjykata veçojnë administratën nga gjyqtarët, zhbllokohet fondi për punonjësit

16/09 13:07



Sherr në Spitalin Memorial, punonjësi ndjek me thikë mjekun kirurg pas përplasjes fizike

16/09 12:35

## Kryesore »




"E respektojmë aktgjykimin e Dhomave të Specializuara"/ Reagon SHBA pas vendimit të Hagës: Të shmanget retorika nxitëse

16/09 15:47



Hetimet për Ballukun/ Pas emaileve për vilën në Palasë, arkitektët merren në pyetje nga SPAK

16/09 15:44



Tension në Prishtinë pas aktgjykimit të Hagës/ Dhjetëra qytetarë protestojnë pranë EULEX-it, hidhen gurë drejt ndërtesës

16/09 15:31



Foto/ "Sot më dhemb Kosova"! Nga Luiz Ejlli te Elvana Gjata, VIP-at shqiptarë reagojnë pas vendimit të Hagës ndaj ish-krerëvetë UÇK-së

16/09 15:27



Gjykata e Lartë kundër projektligjit për pagat e magjistratëve: Kuvendi të mos e votojë

16/09 15:19



"I padrejtë dhe thellësisht zhgënjyes", Ali Ahmeti reagon pas vendimit të Hagës për liderët e UÇK-së: Procesi nuk përfundon këtu

16/09 14:53

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »




"Topin e kam unë" së shpejti në Top Channel! Apliko tani në top-channel.tv



Top Channel/ Sulmohet me thikë mjeku që mjekoi vrasësin Nuredin Dumani




Top Channel/ Avokatët: Do apelojmë. Reagon mbrojtja e Thaçit, Krasniqit, Veselit dhe Selimit










Top News – Avioni i Zelenskit në shënjestër / Rusia sulmoi Moldavinë, 'për pak u godit nga një dron'

Top News- Mbaroi një betejë, jo lufta / Avokatët e krerëve të UÇK: Apelojmë vendimin

Top News- Dënimi i krerëve të UÇK/ Padrejtësia e Hagës bashkon politikën në Kosovë

**Lajme**
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

**Bota**
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

**Sport**
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

**Pop News**
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

**Programe**
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

**Top Channel**
- Rreth Top Channel
- Topin e kam unë – Apliko tani!
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.